




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-0 /DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	01-4265/12
Data Datum Date	26.11.2012
PRISHTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **22.11.2012**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-2433/12, për ztr. *Nuhi Ahmeti* – Drejtor në Bordin e e Postë dhe Telekomin e Kosovës (PTK), për shkak se është shhangur situata me konflikt interesë në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-2433-12, pas zhvillimit të procedurës, është konstatuar se zyrtari i lartë publik ka shhangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2433-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Nuhi Ahmeti – Drejtor në Bordin e Postë dhe Telekomi i Kosovës (PTK), është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në një biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit, konsiderohet papajtushmëri funksionesh (neni 15, pika 1), zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, ztr.Ahmeti është paraqitur ne takim me zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas kësaj bisede, zyrtari i lartë, ztr. Nuhi Ahmeti ka dekluaruar se, menjehershë ka filluar procedurat për parandalimin e konflikti të mundshëm të interesit.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, ztr.Ahmeti, me datën 16.11.2012, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjellur një shkresë zyrtare si dhe dokumentin zyrtar nga ARBK-ja (DPK.DPKI-03-4177/12), me informacionet e reja mbi biznesin; N.T.P."Natyra", në të cilat shihet se ai, tashmë, në mënyrë vullnetare, e ka shuar në tërsi këtë biznes.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korruptionit

Hasan Preteni

